

20 nëntor 2025,
Prishtinë

Bazuar në Rregulloren për Punën e Komisionit të Ankesave dhe të Arbitrazhit të Federatës së Basketbollit (FBK) të datës 31.01.2025, dhe Rregullores për Regjistrim dhe Kalim (RRRK) të datës 20.08.2025, si dhe sipas Ankesës së KB GO+ Peja të datës 17.11.2025, Komisioni i Ankesave dhe Arbitrazhit i FBK-së ("KAA"), me datë 20.11.2025 merr këtë:

V E N D I M

- I. Shpallet e PRANUESHME Ankesa e KB GO+ Peja e datës 17.11.2025;
- II. REFUZOHET Ankesa e KB GO+ Peja e datës 17.11.2025 si e PABAZUAR;
- III. VËRTETOHET Vendimi Nr. 11/2025-26 i Komisionit të Garave i datës 11.11.2025.

A R S Y E T I M

Më datë 17.11.2025, Komisioni i Ankesave dhe Arbitrazhit i FBK-së ("KAA"), përmes postës elektronike, nga Sekretarja e FBK, ka pranuar Ankesën e KB GO+ Peja të datës 17.11.2025 (tash e tutje "Ankesa"), e cila ka të bëjë me Vendimin me nr. 11/2025-26 të Komisionit të Garave të datës 11.11.2025, (tash e tutje "Vendimi"), lidhur me miratimin e kërkesës së KB Bashkimi për lejimin e regjistrimit të lojtarit Muhamedali Janjeva.

Në këtë kuadër, KAA ka mbajtur takim lidhur me çështjen në fjalë, më 20.11.2025, dhe ka shqyrtuar Ankesën e KB GO+ Peja, si dhe provat e tjera që janë pjesë e dosjes së lëndës dhe të ofruara nga sekretaria.

Sipas kuptimit të KAA, KB GO+ Peja sfidon Vendimin e KG të identifikuar më sipër duke pretenduar ndër të tjera se lojtari Muhamedali Janjeva ka luajtur dy (2) xhiro zyrtare për KB Sigal Prishtina në edicionin 2025/26, dhe si i tillë nuk mund të trajtohet nga KG si lojtar i lirë "free agent". Rrjedhimisht, kërkon ndër të tjera nga KAA që të anulojë Vendimin e KG, të pezullojë regjistrimin e lojtarit për KB Bashkimi deri në vendim final, të bëjë verifikimin zyrtar të paraqitjeve të lojtarit për KB Sigal Prishtina; dhe të regjistrojë ndeshjen e xhiros VI në mes të KB Bashkimi-KB GO+ Peja të zhvilluar më datë 15.11.2025 sipas Nenit 55.1 të PG.

KAA vëren nga provat në shkresat e lëndës, dhe është e pakontestueshme, se KB GO+ Peja ka dorëzuar brenda afatit ankesën e tyre ndaj Vendimit të Komisionit të Garave, dhe rrjedhimisht, konsiderohet si ankesë e pranueshme sepse janë përmbushur të gjitha kushtet, përfshirë edhe pagesën e taksës për ankesë.

KAA gjatë trajtimit të lëndës ka shqyrtuar të gjitha dokumentet përkatëse dhe provat në dispozicion, bazën ligjore dhe nënligjore, dhe rregullativën e brendshme të FBK-së, dhe ka konstatuar si në dispozitiv, për arsyet në vijim.

KG ka trajtuar përmes një vendimi tjetër, përkatësisht Vendimit nr. 10/2025-26 të datës 08.11.2025 çështjen nëse lojtari Muhamedali Janjeva mund të merr statusin e lojtarit të lirë “free agent” jashtë afatit kalimtar. Bazuar në kompetencat që ka KG, këtë vendim e ka marrë duke miratuar kërkesën e lojtarit dhe shpalljen e tij me status të lojtarit të lirë “free agent”. KAA vën re se ndaj këtij vendimi nuk ka pasur ankesë nga ndonjë palë e interesit, rrjedhimisht, me skadimin e afatit për ankesë, ky Vendim ka marrë formën e prerë dhe është bërë i plotfuqishëm, me që rast, lojtari në fjalë ka fituar statusin e lojtarit të lirë “free agent”.

Rrjedhimisht, gjatë shqyrtimit të kërkesës së KB Bashkimi për regjistrim të lojtarit Muhamedali Janjeva si lojtar i lirë “free agent” jashtë afatit kalimtar, KG me Vendimin 11/2025-26 të datës 11.11.2025, nuk ka ri-vlerësuar nëse lojtari në fjalë konsiderohet lojtar i lirë “free agent”, por thjeshtë, ka vlerësuar nëse kushtet për regjistrim të këtij lojtari (që veç ka zotëruar statusin e lojtarit të lirë “free agent”) janë përmbushur për tu regjistruar i njëjti si lojtar i KB Bashkimi. KAA vlerëson se nuk ka asnjë provë të ofruar nga KB GO+ Peja që do të dëshmonte se nuk është përmbushur ndonjë nga kushtet e RRRK-së për të lejuar regjistrimin e lojtarit Muhamedali Janjeva si lojtar i KB Bashkimi, pasi që ky veç ka pasur statusin e lojtarit të lirë “free agent”.

Duke vlerësuar këtë, nuk ka asnjë bazë ligjore ose të rregullativës së FBK-së, e cila do të arsyetonte përmbushjen e kërkesave ankimore të KB GO+ Peja në ankesën e parashtruar, prandaj, ato refuzohen si të pabazuara.

Prandaj, KAA duke u mbështetur në atë që u tha më lartë, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Komisioni i Arbitrazhit:



Partin Pruthi
Anëtar



Korab R. Sejdiu
Kryetar



Lulzim Fushtica
Anëtar

Prishtinë, 20 nëntor 2025

Vendimi i dërgohet:

- KB GO+ Peja
- Komisionit të Garave të FBK-së
- Anëtarëve të Komisionit të Arbitrazhit
- Arkivit të FBK-së

***Këshilla Juridike:***

Vendimet e Arbitrazhit janë definitive, dhe kundër tyre nuk është e lejuar ankesa brenda FBK-së. Palët e pakënaqura me vendimin e KAA kanë të drejtë të ankesës tek Këshilli i Arbitrazhit Sportiv (KAS) dhe në Gjykatën kompetente përkatëse.